

---

**STATUTI**  
**I SHOQERISE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE**  
**CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND**  
**TOURIST COMPLEXES” SHPK**

---

ES → A

**STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE  
CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF  
CITIES AND TOURIST COMPLEXES” SHPK**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND TOURIST COMPLEXES” Sh.p.k, që këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”, zoterohet nga ortaku:

- 1- **HUSSEEN MAHMOD ABAAS AL-JBUORY** atesia **MAHMOD**, shtetas IRAKIAN, lindur me 14/01/1975 ne IRAK, identifikohet nepermjet pasaportes A14085729.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë Statut të shoqërisë “EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND TOURIST COMPLEXES” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**KAPITULLI I  
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,  
SELIA, TERRITORI**

**NENI 1  
FORMA DHE EMRI**

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale Sh.P.K., të cilat vijnë përpara ose menjëhere pas emrit të shoqërisë. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

1.2 Emri i shoqërisë është “EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND TOURIST COMPLEXES” Shpk

1.3 Forma dhe emri i shoqërisë mund të ndryshohen me vendim të Asamblese së Pergjithshme të Ortakeve.

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, në përputhje me legjislacionin shqiptare në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me



marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

### **NENI 3 SELIA**

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "DESHMORET" Lagja nr.4, Godina me xhama afer karburant ALPET, Kati i 2 , Zyra 19, Nr. Pronesie 6/62, zona kadastrale 8514, Durrës, Shqipëri.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim të asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose përfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

### **NENI 4 TERRITORI**

**4.1** Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

**4.2** Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyrat, filialet ose përfaqësitë e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

## **KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQËRISË**

### **NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria "EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND TOURIST COMPLEXES" Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie e cila ka si objektive punime në fushën e ndërtimit.

### **NENI 6 KOHEZGJATJA**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure



likujdimi me vendim të Asamblese së Ortakeve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

**KAPITULLI III**  
**KONFIDENCIALITETI,**  
**DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET**

**NENI 7**  
**KONFIDENCIALITETI**

Ortakët e shoqërise si dhe personat e tjere të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojne asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhe, çdo lloj material, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

**NENI 8**  
**DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET**

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojne lexueshem emrin e shoqërise dhe pas tij fjalet “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “Sh.P.K.”, si dhe emrin e administratorit ose te administratorëve.

**KAPITULLI IV**  
**KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET,**  
**PJESET DHE TRASFERIMI I TYRE**

**NENI 9**  
**KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndare në 1 pjese.Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:


<b>1. HUSSEEN MAHMOD ABAAS AL-JBUORY</b>	<b>100,00%</b>	<b>100.000,00 LEKE</b>
--	----------------	------------------------

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

**NENI 10**  
**TE DREJTAT E ORTAKEVE NE LIDHJE ME KAPITALIN**

**10.1** Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.



*Aplikanti*  
*Marcela 1974*  


**10.2** Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar, i perket ortakëve e drejta me opcion mbi kapitalin në zmadhim, në proporcion me kuotën e kapitalit që kanë në pronesi. Nëse ndonjëri nga ortakët nuk do të nënshkruajë kuotën e tij të kapitalit në zmadhim, e drejta e opcionit do të perkase ortakëve të tjerë. Duke mos e ushtruar ortakët të drejtën e opcionit, kapitali në zmadhim i panënshkruar do të nënshkruhet nga palë të treta.

**10.3** Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

**10.4** Kuotat e kapitalit të shoqërisë nuk mund të rendohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përmbushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra përmbarimore ose ndonjë organ tjetër kompetent), duhet të ketë në konsideratë respektimin e kërkesave të nenit 13 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin të shpjegojë nën 13 të këtij statuti subjektin në favor të cilit vendoset barra siguroese.

**10.5** Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes në kapital.

**10.6** Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërisë kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërisë, si dhe të konsultojnë dokumentet kontabel e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

## **NENI 11**

### **FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT**

Fusha e autoritetit të ortakëve, përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kontributin e çdo ortaku në kapitalin e shoqërisë, si dhe kompetencat që gezon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

## **NENI 12**

### **FINANCIMI I SHOQËRISË**


**12.1** Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga ortakët fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërisë.

**12.2** Financimet e mëtejshme të ortakëve do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

## **NENI 13**

### **TRANSFERIMI I PJESEVE TË KAPITALIT**

**13.1** Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të transferohen lirisht mes ortakëve të shoqërisë. Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të



trasferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërisë në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtës së parablerjes.

**13.2** Trasferimi i kapitalit themeltar të shoqërisë ose i pjeseve të tij tek persona të tretë bëhet vetëm në këtë mënyrë:

- Oferta për shitje u drejtohet të gjithë ortakëve me shkrim;
- Oferta duhet të përcaktojë numrin e kuotave që shiten dhe çmimin e tyre;

Nëse ortakët e shoqërisë brenda 3 (tre) muaj nga oferta me shkrim nuk pranojnë blerjen e kuotave të ofruara me çmimin e përcaktuar, atëherë konsiderohet se ata lejojnë shitblerjen tek të tretët.

**13.3** Kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshem në rrugë trashigimie. Bashkshorti, paraardhësi dhe pasardhësi mund të bëhen ortakë nëpërmjet transferimit të pjeseve të kapitalit themeltar sipas kushteve që lejohen në ligj.

**13.4** Transferimet e pjeseve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me akt noterial dhe të depozitohen në organin kompetent.

**13.5** Klauzolë miratimi. Nëse asnjë ortak nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes në kohë dhe sipas kushteve të parashikuar për transferimin e kuotave apo të drejtën e opcionit, kalimi i kuotave nuk do të mund të bëhet pa pëlqimin e Asamblese së Ortakëve që vendos për pranimin e transferimit të një personi të tretë.

Ortakët mbledhen jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë, nëpërmjet Asamblese të Zakonshme të Ortakëve, duke vendosur me votën pro (në favor) me të paktën gjysmën e kapitalit themeltar.

**13.6** Pëlqimi mund të refuzohet vetëm kur blerësi nuk jep garanci të mjaftueshme rreth kapaciteteve financiare ose për kushtet objektive o për aktivitetin që kryen, të tilla që hyrja e tij në shoqëri mund të jenë e dëmshme për arritjen e objektivave nga shoqëria ose konflikt me interesat e shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Asambleja e Ortakëve duhet të njoftojë me shkrim në adresën që rezulton vendimin për miratim.

Nëse brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës për miratim ortaku kërkues që nuk ka marrë asnjë komunikim miratimi do të konsiderohet si i dhënë dhe ortakët mund të transferojnë kuotën e tyre.

**13.7** Nëse miratimi i mohohet do të prezantohet një tjetër blerës. Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakëve duhet të tregojë në letrën e refuzimit emrin e blerësit të propozuar; transferimi duhet të plotësohet me të njëjtat kushte të përcaktuara në kërkesën për miratim nga ana e aplikantit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas marrjes së komunikimit të fundit.

Përndryshe, ortaku do të jetë i lire për të shitur pjesëmarrjen e tij personit që konsideron me të përshtatshëm.



**KAPITULLI V**  
**ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

**NENI 14**  
**ORGANET DREJTUESE**

**14.1** Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësojë shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë do ti referohemi me termin Asamble e Ortakëve.

**14.2** Shoqëria mund të emerojë më shumë se një Administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar Administratorin e shoqërisë "EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND TOURIST COMPLEXES" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë Administratorët e saj sado qofshin këta në numër.

**14.3** Përveç organeve të parashikuara me sipër Asambleja e Ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezigjatja dhe kompetencat e tyre.

**14.4** Administratorët e shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare janë emëruar :  
Te cilët mund të ushtrojnë kompetencat e tyre bashkarisht, ose vec e vec.

**1. HUSSEEN MAHMOD ABAAS AL-JBUORY**

**2. ANXHELA AGA**

**KAPITULLI VI**  
**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

**NENI 15**  
**VENDIMET E ASAMBLESE TE ORTAKEVE**

**15.1** Asambleja e Ortakëve vendos për çështjet që ligji apo ky statut i rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakëve.

**15.2** Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 % të kuotave të kapitalit themeltar.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas ligjit mbi shoqëritë tregtare, ajo mund të marrë vendime



te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se 75 % te numrit total te kuotave te kapitalit themeltar jane te pranishem dhe vendosin me voten e  $\frac{3}{4}$  (tre te katertave).

#### **NENI 16**

##### **KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKEVE**

**16.1** Ne perputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakeve mund te merren pas nje konsultimi me shkrim qe organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Ne kete rast, organi administrativ i komunikon ortakeve tekstin e projekt-vendimit qe do te merret dhe i kerkon te shprehin vullnetin e tyre ne lidhje me kete çeshtje.

**16.2** Vendimet e marra ne kete menyre jane te vlefshme kur vendimi merret nga shumica qe ligji apo ky statut kerkon per ate çeshtje.

#### **NENI 17**

##### **MENYRA DHE VENDI I THIRRJES I ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

**17.1** Asambeja e Ortakeve thirret prane selise se shoqerise, apo ne ndonje vend tjeter brenda Republikes se Shqiperise, nepermjet nje njoftimi me shkrim edhe nepermjet postes elektronike (E-mail), duke e konfirmuar marrjen, qe iu dergohet ortakeve nga Kryetari i Asamblese se Ortakeve dhe / ose Organi Administrativ.

**17.2** Njoftimi i thirrjes se mbledhjes se asamblese duhet te kryhet 15 (pesembedhete) dite perpara dates se mbledhjes dhe duhet te percaktoje shprehimisht daten, oren, vendin si dhe rendin e dites. Ne rast pamundesie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblese se ortakeve mund te thirret nga esporti kontabel i autorizuar, nese ka te tille, ose nga nje apo me shume ortake, te cilet perfaqesojne jo me pak se 10% te kapitalit te shoqerise.

#### **NENI 18**

##### **KRYETARI I ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

**18.1** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve emeron Kryetarin e Asamblese.

**18.2** Kryetari i Asamblese verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt te Asamblese se Ortakeve, verteton identitetin apo legjitimimin e perfaqesuesit te ortakeve dhe drejton zhvillimin e rregullt te mbledhjes.





## NENI 19

### PJESEMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak ka te drejten e nje vote per çdo kuote te kapitalit themeltar te shoqerise qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjen e asamblese nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete, nepermjet nje akti perfaqesimi me shkrim.

## NENI 20

### KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

**20.1** Asambleja e Ortakeve mund te jete e zakonshme dhe e jashtezakonshme, kjo ne varesi te çeshtjes per te cilen eshte thirrur. Vendimet e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve merren me shumice te thjeshte te votave te ortakeve. Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve merren me nje shumice te cilesuar prej  $\frac{3}{4}$  (tre te katertave) te votave te ortakeve te shoqerise. Per çfare nuk eshte pasqyruar ne kete nene, Asambleja e Ortakeve te shoqerise vendos ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14. 04. 2008.

**20.2** Kompetencat e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve do te jene:

- Vendos per perpilimin ose miratimin e rregulloreve per shoqerine apo per fusha te veçanta te veprimtarise.
- Vendos per ndryshimin e selise se shoqerise.
- Vendos per krijimin e zyrave ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive ose te ortakerive me persona te tjere fizike apo juridike.
- Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise, ekspertin kontabel, likujdatori duke percaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, te drejtat, detyrimet, kohezgjatjen ne detyre, dhe shperblimin e tyre.
- Vendos ne lidhje me krijimin e organeve te tjera drejtuese qe mund t'i nevojiten shoqerise duke percaktuar ne aktet e krijimit te ketyre organeve, kohezgjatjen dhe kompetencat e tyre, per emerimin e personave drejtues te ketyre organeve.
- Asambleja e Ortakeve marrjen e vendimeve e kryen vete dhe nuk ben delegimin e vendimarrjes te asnje organ tjeter. Asambleja e Ortakeve vendos edhe ne lidhje me krijimin e sektoreve te veçante te veprimtarise se shoqerise.
- Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor.
- Miraton tarifat e sherbimeve te shoqerise.
- Miraton pagat e te punesuarve ne shoqeri.

**20.3** Kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve jane:

- Vendos ne lidhje me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Vendos ne lidhje me kohezgjatjen e shoqerise si dhe per mbarimin e likujdimin e saj.
- Vendos per ndryshimin e emrit te shoqerise.



- Vendos ne lidhje me ndryshimin e statutit te shoqerise.
- Vendos per ndryshimin e formes, per ndarjen e shoqerise si dhe per bashkimin e saj me shoqeri te tjera.
- Percakton llojin e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, percaktimin e dividendit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.
- Realizon marredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te shoqerise me persona te tjere fizik apo juridik, vendas apo te huaj.
- Vendos ne lidhje me transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.

**20.4** Pervec kompetencave te lartpermendura, te cilat jane ekskluzive per te, Asambleja e Ortakeve ushtron çdo kompetence qe ia njihet ligji.


## NENI 21

### ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

**21.1** Kompetencat e Administratorit ose te Administratoreve, te cilet mund edhe te mos jene ortake te shoqerise, ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Veç te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, Administratori ka edhe keto kompetenca:

- Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet Asamblese se Ortakeve per shqyrtim.
- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne shoqeri.
- Ndjek problemet e shoqerise ne marredhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon Asamblese se Ortakeve tarifat e sherbimeve dhe pagat per personelin e punesuar ne shoqeri.
- I propozon Asamblese se Ortakeve rregulloren e shoqerise.
- Administratoret kane te drejte te gjithë sebashku ose veçmas nga njeri tjetri te perfaqesojne shoqerine ne lidhje me te tretet.

**21.2** Administratori ose Administratoret jane pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate ushtrimit te administrimit te shoqerise. Pergjegjesia eshte individuale ose solidare, kjo ne varesi te rrethanave dhe te menyres se si eshte vepruar, pra individualisht ose solidarisht.



**21.3** Administratori o Administratoret nuk jane pergjegjes ndaj shoqerise ose te treteve per konfliktin e interesit qe mund te krijohet duke zhvilluar pozicione te ndryshme ose te ngjashme ne shoqeri dhe organizma te ndryshem.

## **KAPITULLI VII** **KONTROLLI KONTABEL,** **BILANCI, DIVIDENTET**

### **NENI 22** **KONTROLLI KONTABEL**

Kontrolli i jashtem kontabel i shoqerise kryhet nga eksperte kontabel te autorizuar, sipas legjislacionit ne fuqi. Asambleja e Ortakeve do te emeruje nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

### **NENI 23** **BILANCI DHE REZERVAT**

**23.1** Bilanci mbyllet ne 31 dhjetor te çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operationet e vitit financiare dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar, i paraqiten per shqyrtim asamblese se ortakeve, e cila vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrezimin e ketyre akteve, kur e konsideron te nevojshme Asambleja e Ortakeve mund te beje rekomandimet e nevojshme ne lidhje me çeshtjen ne diskutim.

**23.2** Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori i vetem merr masat e nevojshme per hartimin e projekt-bilancit te aktivitetit per vitin financiar te mbyllur, ne menyre qe Asambleja e Ortakeve te vendose mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve te percaktuara nga ligji.

**23.3** Asambleja e Ortakeve vendos mbi ndarjen ndermjet ortakeve te shumave qe rezultojne si fitime sipas bilancit te aprovuar rregullisht, pasi nga keto shuma te jene zbritur humbjet e mundshme te viteve te meparshme, si dhe te jene lene menjane shumat e nevojshme per krijimin e rezerves ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5 % te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit financiar, deri sa te arrihet nje shume e barabarte me 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

**23.4** Asambleja e Ortakeve ne çdo moment mund te vendose krijimin e rezervave te tjera, si dhe masen e tyre.

## **KAPITULLI VIII** **MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE,**



## **LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE**

### **NENI 24 MBARIMI**

Shoqeria mbaron me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsyet e parashikuara ne ligj.

### **NENI 25 LIKUJDIMI**

**25.1** Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja e Ortakeve cakton nje ose disa likujdues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

**25.2** Ne fund te procesit te likujdimit, Asambleja e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

**25.3** Mbas pagimit te kreditoreve Asambleja e Ortakeve mban pjesen e mbetur te kapitalit qe u shpemdahet ortakeve.

### **NENI 26 LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE**


**26.1** E drejta e largimit lejohet ne rastet e parashikuara me ligj.

Njoftimi i largimit duhet ti dergohen shoqerise me shkrim dhe duhet te perfshijë emër mbiemër të ortakut që largohet, vendbanimin, për komunikimet e nevojshme mbi procedurën e largimit dhe numrin e kuotave në lidhje me të cilat synon të largohet motivimet përkatëse.

Ortakët që largohen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin një rimbursim të kuotave në proporcion të kapitalit të shoqërise. Për këtë qëllim është përcaktuar duke marrë parasysh vlerën e tij të llogaritur në bazë të kapitalit neto.

**26.2** Shlyerja e kuotave për të cilën është ushtruar e drejta e largimit duhet të bëhet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga komunikimi që i bëhet shoqërise. Ajo gjithashtu mund të bëhet me anë të blerjes nga ortakët e tjerë në proporcion me pjesëmarrjen e tyre ose nga një palë e tretë të identifikuar në mënyrë unanime nga ortakët. Për këtë qëllim, administratorit i kërkohet që të njoftojë ortakët e tjerë mbi mbarëvajtjen e procedurës së largimit të ortakut, dhe t'ia ofrojë për shitje, në emër dhe për llogari të ortakut që largohet, pjesën mbi të cilën është ushtruar largimi, duke deklaruar çmimin e kuotes dhe afatin për pagesën e saj, jo më shumë se 3 (tre) muaj. Për shitjen zbatohen rregulla mbi ushtrimin e së drejtës të parablerjes në këtë Statut.

**26.3** Ortakët duhet të informojnë shoqërinë për qëllimin e tyre për të blerë kuotat e ortakut që largohet ose emrin e palës së tretë blerëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga



marrja e komunikimit nga shoqëria dhe qëllimin e ortakut për t'u larguar. Nëse oferta është pranuar nga shumica e ortakëve, pjesa e ortakut që largohet do të ndahet në proporcion midis ortakëve në bazë të kuotave përkatëse që kanë në kapitalin themeltare.

Nëse kjo nuk ndodh, rimbursimi do të bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme ose në mungesë përkatësisht zvogëlimin e kapitalit; nëse nuk është e mundur një rimbursim i kuotave të ortakut që largohet, atëherë shoqëria vendoset në likuidim.

**26.4** Përfundimi i ortakut mund të bëhet, në rast të vonës apo pamundësisë së kryerjes të punës ose shërbimeve që mund të kryhen nga një ortakë.

Përfundimi duhet të përcaktohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve me tre të katërtat e votave.

Pas zbulimit të vendimit për të përfunduar ortakun, ky i fundit është i penguar për të ushtruar të drejtat shoqërore.

**26.5** Për likuidimin e kuotës të ortakut që largohet, aplikohet procedura e rimbursimit e parashikuar për largimin, përfunduar këtu mundësia e shlyerjes së kuotës nëpërmjet reduktimit të kapitalit themeltare dhe likuidimin e mundshëm të shoqërisë.

Përfundimi mund të revokohet, derisa kuota e ortakut të përfunduar nuk i është rimborsuar.

## **KAPITULLIX**

### **MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITA TE FUNDIT**

#### **NENI 27**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**


Çdo mosmarreshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do të angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarreshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

#### **NENI 28**

#### **DISPOZITA TE FUNDIT**

**28.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me ligjin shqiptarë. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e legjislatcionit shqiptarë në fushën e shoqërive tregtare si dhe legjislatcionit shqiptarë në përgjithsi.

**28.2** Shoqëria do të ketë vulën, stemen, logon dhe faqen e internetit (website), format dhe madhësitë do të përcaktohen nga asambleja e ortakëve në veçanti dhe me propozim të administratorit.



28.3 Ky Statut eshte hartuar ne 3 (tre) ekzemplare, duke patur secili ekzemplare fuqi te njejte ligjore.

Tirane,03/02/2021

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE  
“EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE  
CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND  
TOURIST COMPLEXES” SH.P.K.**

**HUSSEEN MAHMOD ABAAS AL-JBUORY**

حسين الجبوري  
A